



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

DOKUMENT PËR DISKUTIM

Krijimi i indeksit të barazisë gjinore në Kosovë

Nga Iliriana Banjska dhe Nicole Farnsworth për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

Prishtinë, Kosovë
Dhjetor 2016

Mbështetur nga:

FEMDEFENDERS
KVINNA TILL KVINNA



Përmbajtja

Mirënjohje	2
Shkurtesat	2
Çfarë është indeksi i barazisë gjinore?	3
Pse i duhet Kosovës indeksi?	3
Rreth këtij dokumenti	4
Indeksi i barazisë gjinore: disponueshmëria e të dhënave për fusha specifike	4
Puna	4
Paraja	6
Njohuritë	8
Koha	9
Pushteti	11
Shëndetësia	13
Rreth pabarazive ndërsektoriale	15
Rekomandimet	19
Shtojca I. Përmbledhje e fushave dhe treguesve	20
Punimet e cituara	28

Mirënjohje

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) falënderon anëtarët e ekipit të cilat kanë punuar në hulumtimin e këtij punimi, Iliriana Banjskën, Donjeta Morinën dhe Nicole Farnsworth. Erëblina Elezaj ka ndihmuar me analiza të mëtejme statistikore të të dhënave ekzistuese të RrGGK-së lidhur me dhunën në baza gjinore. Ky hulumtim është mundësuar me mbështetjen financiare të Fondacionit “*Kvinna till Kvinna*”.

Shkurtesat

ABGj	Agjencia për Barazi Gjinore
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
BE	Bashkimi Evropian
DG	Direktorati i Përgjithshëm
EU-SILC	Statistikat e Bashkimit Evropian për të Hyrat dhe Kushtet e Jetës
IEBGj	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
HLY	Vitet e Shëndetshme të Jetës
KSNA	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OBEZH	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
SFB	Standardi i Fuqisë Blerëse
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë

Çfarë është indeksi i barazisë gjinore?

Indeksi i barazisë gjinore është një tregues i cili bashkon në një vend disa matje tjera të barazisë gjinore.¹ Ai përdoret për të matur, me kalimin e kohës, ndryshimet në barazinë gjinore brenda shteteve anëtare të veçanta të Bashkimit Evropian (BE), dhe gjithashtu në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Duke pasur parasysh që barazia gjinore është koncept kompleks me mijëra matje potenciale, indeksi bazohet në një përzgjedhje të treguesve specifik, shumica e të cilëve kanë të bëjnë me politikat e BE-së. Dimensionet e indeksit përfshijnë: punën, paratë, njohuritë, kohën, pushtetin, shëndetin, dhunën dhe pabarazitë e ndërthurura. Për të krijuar indeksin e barazisë gjinore, i cili paraqet një matje të vetme të barazisë gjinore, kombinohen së bashku tregues që kanë të bëjnë me secilën nga temat e sipërpërmendura. Prandaj, edhe pse indeksi është mjaft kompleks, ai thjeshtohet në mënyrë që t'iu mundësojë si njerëzve ashtu edhe politikë-bërësve ta përdorin këtë instrument në monitorimin e performancës së vendit të tyre në avancimin e barazisë gjinore.

Pse i duhet Kosovës indeksi?

Indeksi i barazisë gjinore është i dobishëm për identifikimin e fushave ku një vend ka vështirësi për të siguruar barazi gjinore. Duke qenë se indeksi i përdor të njëjtat matje të herëpashershme, ai gjithashtu iu mundëson vendeve që ta përcjellin progresin me kalimin e kohës, duke i evidentuar në këtë mënyrë të arriturat dhe duke i lokalizuar fushat ku ka nevojë të punohet më shumë. Në këtë kuptim, indeksi i barazisë gjinore mund të shërbejë si udhëzues për politikë-bërësit si dhe për aktivistët e të drejtave të grave lidhur me fushat ku nevojitet veprim ose reforma të mëtejme.

Ndonëse Kosova ende nuk është shtet anëtar i BE-së, krijimi i indeksit për barazi gjinore në Kosovë mund të ketë disa përfitime. Së pari, Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës thërret për mbledhje të rregullt dhe përdorim të statistikave sipas gjinisë.² Derisa për Qeverinë e Kosovës mund të jetë financiarisht e pamundur që menjëherë të financojë mbledhjen e të dhënave statistikore për të gjitha matjet e mundshme të barazisë gjinore, indeksi mund të udhëzojë Qeverinë e Kosovës të përzgjedhë se cilët tregues kyç të barazisë gjinore do të duhej t'i matë. Së dyti, të dhënat e mbledhura në lidhje me indeksin e barazisë gjinore mund të jenë shumë të dobishme për Kosovën për të ofruar informata për politikat dhe programet e saj nga perspektiva gjinore, duke përfshirë edhe matjen e progresit me kalimin e kohës lidhur me planet kombëtare të veprimit, si dhe në përputhje me kërkesat e reja për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Së treti dhe më konkretisht, matjet e standardizuara të përdorura në indeksin e barazisë gjinore mund të jenë të dobishme për matjen e progresit drejt barazisë gjinore si pjesë e programit të ardhshëm të Kosovës për barazi gjinore, i cili do të hartohet në vitin 2017, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore. Treguesit nga indeksi i barazisë gjinore do të mund të integroheshin në këtë program të ri, aty ku mund të jetë e përshtatshme, duke siguruar kështu të dhëna kyçe krahasimore dhe duke mundësuar matjen e përmirësimeve me kalimin e kohës.

Së katërti, përtej Kosovës, krijimi i indeksit të barazisë gjinore do të mundësojë bërjen e krahasimeve midis Kosovës dhe shteteve të tjera anëtare të BE-së, si dhe vendeve të tjera në proces për anëtarësim. Serbia, për shembull, ka krijuar indeksin e barazisë gjinore në vitin 2016.³ Së pesti, si pjesë e procesit të vazhdueshëm të Kosovës për anëtarësim në BE, matja e herëpashershme dhe e qartë e barazisë gjinore mund të jetë e dobishme për të kuptuar se si mund të jetë duke kontribuar vetë procesi i anëtarësimit në BE në barazinë gjinore, diçka që ka qenë e vështirë për t'u matur dhe monitoruar në të kaluarën.⁴ Identifikimi i praktikave më të mira në avancimin e barazisë gjinore në Kosovë si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE do të mund të ishte i dobishëm si për politikë-bërësit ashtu dhe për

¹ Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGj), Indeksi i Barazisë Gjinore 2015; *Matja e Barazisë Gjinore në Bashkimin Evropian 2005-2012*, Itali: IEBGj, 2015, f. 7.

² Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazinë Gjinore, nr. 05/L-020, 28 maj 2015.

³ 'Serbia - vendi i parë kandidat për BE që ka krijuar indeksin e barazisë gjinore', IEBGj, 2 shkurt 2016, vizituar më 10 dhjetor 2016, në: <http://eige.europa.eu/news-and-events/news/serbia-first-eu-candidate-country-produce-gender-equality-index?lang=en>.

⁴ Shih RrGGK 'Si mund të ndikojë anëtarësimi në BE në barazinë gjinore në Kosovë?' Dokument për diskutim, Prishtinë: RrGGK, 2016.

akademikët. Së gjashti, dhe shumë e ndërlidhur, krijimi i indeksit të barazisë gjinore në Kosovë do të ndihmonte në standardizimin e mbledhjes së statistikave të dobishme të cilat do t'i mundësonin Zyrës së BE-së në Kosovë, ndër të tjera, të matë më mirë progresin e avancimit të barazisë gjinore në Kosovë, në përputhje me objektivat e përcaktuara në planin e ri të veprimit për barazi gjinore të BE-së.⁵

Rreth këtij dokumenti

Ky punim shtjellon dimensionet e ndryshme të indeksit të barazisë gjinore dhe e shqyrton shkallën e disponueshmërisë së të dhënave statistikore në Kosovë për secilin tregues. Punimi synon që, Agjencisë për Barazi Gjinore (AGjE) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Zyrës së BE-së në Kosovë, mbështetësve financiarë potencial të tjerë për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave sipas gjinisë në Kosovë dhe aktivistëve për të drejta të grave si shfrytëzues të të dhënave të tilla, t'u ofrojë një pasqyrë të disponueshmërisë aktuale të të dhënave që kanë të bëjnë me indeksin në Kosovë, si dhe rekomandime praktike për krijimin e indeksit në Kosovë.

Indeksi i barazisë gjinore: disponueshmëria e të dhënave për fusha specifike

Indeksi i barazisë gjinore ka shtatë fusha, ku secila përbëhet nga nën-fusha. Kjo pjesë shqyrton secilën fushë, nën-fushë si dhe disponueshmërinë aktuale në Kosovë të të dhënave që kanë të bëjnë me këto fusha. Ky punim fokusohet në atë se si të mblidhen të dhënat e nevojshme në Kosovë, me qëllim të krijimit të këtij indeksi; ai nuk jep detaje se si krijohet vetë indeksi, pasi kjo informatë është në dispozicion tjetërkund.

Puna

Fusha e punës, siç shpjegon IEBGj, 'mat shkallën në të cilën gratë dhe burrat mund të përfitojnë nga qasja e barabartë në punësim dhe kushte të përshtatshme të punës'.⁶ Kjo fushë përbëhet nga tri nënfusha për pjesëmarrje, punë dhe cilësi të punës. Tabela 1 përmbledh konceptin, treguesin dhe burimin e EIGE-së, që nxirret drejtpërdrejt nga IEBGj. Dy kolonat e fundit tregojnë nëse Kosova ka të dhëna aktualisht dhe se si Kosova konsideron ndërmarrjen e hapave për të vendosur këtë tregues. Tabelat në vijim përdorin të njëjtin format të prezantimit.

Pjesëmarrja përfshin dy matje: normën ekuivalente të punësimit me orar të plotë dhe jetëgjatësinë (vitet) e punës. Norma ekuivalente e punësimit me orar të plotë matet me përqindjen e popullsisë të moshës 15 dhe më të vjetër të cilët janë të punësuar me orar të plotë. Në Kosovë, këto të dhëna mblidhen nga ASK-ja përmes Anketës së saj Vjetore të Fuqisë Punëtore (AFP), që mbledh të dhëna për personat me grupmosha të njëjta.⁷ Anketa gjithashtu mbledh informata në lidhje me punësimin me gjysmë-orar dhe numrin e orëve të punës sipas gjinisë. Prandaj, të dhënat e AFP-së mund të përdoren për të llogaritur punësimin ekuivalent me orar të plotë.

Matja e dytë, jetëgjatësia (vitet) e punës, nuk duket të jetë në dispozicion në Kosovë për momentin. Megjithatë, ajo ndoshta mund të llogaritet me të dhënat ekzistuese, duke shfrytëzuar të njëjtin model të probabilitetit të përdorur nga Eurostat, që nxirren nga të dhënat demografike dhe të dhënat e tregut të punës.

Nënfusha e ndarjes dhe cilësisë së punës përfshin matjen e tri koncepteve: ndarjes, marrëveshjeve fleksibile personale /familjare dhe intensitetin e punës. Ndarja është operacionalizuar si përqindje e njerëzve të moshës 15-64 të cilët janë të punësuar në arsim ose në shëndetin e njeriut dhe

⁵ Këshilli i Bashkimit Evropian, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, 'Përfundimet e Këshillit lidhur me Planin e Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020', Bruksel: Këshilli i Bashkimit Evropian, 2015.

⁶ Po aty, f. 28.

⁷ ASK, *Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore në Kosovë për vitin 2016*, Prishtina: 2016, marrë nga: <http://ask.rks-gov.net/media/1684/rezultatet-e-anketes-se-fuqise-punetore-2015-ne-kosove.pdf>. AFP mund të mos jetë e mjaftueshme për të matur numrin e personave të cilët punojnë në ekonominë joformale, edhe pse anketa përmban një pyetje lidhur me punën pa kontratë.

në aktivitete të punës shoqërore. Pasi që Kosova tashmë rregullisht mbledh informata në lidhje me gjininë, moshën, statusin e punësimit dhe aktivitetin e punës përmes AFP, këto të dhëna mund të shfrytëzohen për të arritur te ky tregues.⁸ Këto të dhëna ekzistuese mund të shfrytëzohen për të krijuar një matje të vetme të përqindjes së përgjithshme të femrave dhe meshkujve, përkatësisht, puna në këta sektorë, si përqindje e njerëzve që angazhohen në të gjitha llojet e ndryshme të aktiviteteve.

Koncepti i marrëveshjeve fleksibile personale/familjare matet me përqindjen e punëtorëve të moshës 15 dhe më të vjetër të cilët kanë 'aftësinë që të marrin një ose dy orë pushim gjatë orarit të punës për t'u kujdesur për çështje personale apo familjare'. Aktualisht, Anketa Evropiane e Kushteve të Punës, e koordinuar nga Eurofound, mat këtë tregues. Kosova nuk ka këto të dhëna, dhe mund të mos jetë e mundur që të përcaktojë tani një anketë krejtësisht të re kushteve të punës. Për një vend të vogël si Kosova, duhet t'i kushtohet kujdes që të shmanget mbi-anketimi i popullsisë. Prandaj, një zgjidhje afat-shkurtër me kosto efektive mund të përfshijë pyetjen si në vijim nga Anketa Evropiane për Kushtet e Punës (pyetja 43) në AFP të rregullt të Kosovës:

A do të thoni se marrëveshja për të marrë një ose dy orë pushim gjatë orarit të punës për t'u përkujdesur për çështje personale apo familjare është ...?

- 1) Aspak e vështirë
- 2) Jo shumë e vështirë
- 3) Disi e vështirë
- 4) Shumë e vështirë

Ndryshorja për marrëveshjet fleksibile personale/familjare atëherë do të llogaritet duke marrë përqindjen e njerëzve të moshave 15 dhe më të vjetër që ishin përgjigjur 'nuk është aspak e vështirë', nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve të plotësuara (përkatësisht personat që janë përgjigjur 1, 2, 3 ose 4).

Koncepti i intensitetit të punës është operacionalizuar duke shqyrtuar përqindjen e punëtorëve të moshave 15 dhe më të vjetër të cilët punojnë me afate të ngjeshura. Përderisa Eurofoundi mbledh informata për këtë çështje në mënyrë të ngjashme duke shfrytëzuar Anketën Evropiane për Kushte të Punës, aktualisht Kosova nuk i ka këto të dhëna në dispozicion. Përsëri, një zgjidhje e propozuar është që të përfshihet kjo pyetje në AFP të rregullt të Kosovës, duke përdorur formulimin origjinal nga Anketa Evropiane për Kushte të Punës (pyetja 45):

Dhe, a përfshin pozita e juaj punë me afat të ngjeshur:

- 1) Tërë kohën
- 2) Gati tërë kohën
- 3) Rreth $\frac{3}{4}$ e kohës
- 4) Rreth gjysmës së kohës
- 5) Rreth $\frac{1}{4}$ e kohës
- 6) Gati kurrë
- 7) Kurrë

Pastaj, kjo ndryshore do të llogaritet si përqindje duke marrë numrin e njerëzve të cilët janë përgjigjur me 1-5 nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve (të cilët janë përgjigjur 1-7).

⁸ ASK, AFP, f. 15.

Tabela I. Puna ⁹					
Korniza e matjes	Koncepti i matur	Treguesi	Burimi	I disponueshëm në Kosovë	Hapat potencial
Pjesëmarrja	Norma e Punësimit EMP	Punësimi ekuivalent me orar të plotë (%popullsia 15+)	Eurostat — EU LFS	Po	Kryeni llogaritjet duke shfrytëzuar të dhëna e AFP -së
	Jetëgjatësia (vitet) e punës	Jetëgjatësia (vitet) e punës	Eurostat — EU LFS	Ndoshta	Ndoshta mund të llogaritjet duke përdorur të dhënat demografike dhe AFP
Ndarja dhe cilësia e punës	Ndarja	Punësimi në arsim, shëndetin e njeriut dhe aktivitetet shoqërore të punës (%të punësuar 15-64)	Eurostat — EU LFS	Po	Përdorin të dhënat e Shfrytëzoni të dhënat AFP mbi punësimin sipas gjinisë, moshës dhe aktivitetit të punës: 'arsim' dhe 'shëndetin e njeriut dhe punë sociale'
	Aranzhimet fleksibile personale/familjare	Aftësia për të marrë një orë ose dy pushim gjatë orarit të punës për t'u kujdesur për çështje personale apo familjare (%punëtorë 15+)	Anketa e Kushteve të Punës së Eurofound	Jo	Inkorporoni në AFP.
	Intensiteti i punës	Puna me afate të ngjeshura (%punëtorë 15+)	Anketa e Kushteve të Punës së Eurofound	Jo	Inkorporoni në AFP

Paraja

Analiza e fushës së parave është e rëndësishme nga perspektiva e barazisë gjinore, pasi sigurimi i të drejtave të barabarta dhe qasja e burimeve dhe grave në burimet financiare janë të domosdoshme për arritjen e pavarësisë ekonomike të barabartë, për të trajtuar rritjen e feminizimit të varfërisë dhe për të penguar pabarazitë në rritje të të ardhurave.¹⁰ Fusha e parave ka dy nënfusha: burimet financiare dhe gjendjen ekonomike.

Burimet financiare maten, së pari, me të ardhurat mesatare mujore. Kjo është llogaritur në bazë të ardhurave mesatare në Standardin e Fuqisë Blerëse (SFB) çdo muaj. Sipas Eurostatit, të ardhurat mujore 'në muajin referencial mbulojnë pagën në të holla, të paguara para çdo zbritje tatimore dhe kontributeve e sigurimeve sociale për t'u paguar nga fituesit e pagave dhe të mbajtura nga punëdhënësi, dhe janë të kufizuara në të ardhurat bruto të cilat paguhen në secilën periudhë të pagesës gjatë muajit referencial.¹¹ Në mbledhjen e këtyre të dhënave, Eurostat përdor Anketën e Strukturës së Pagave që fokusohet në "sektorët e industrisë, të ndërtimitarisë dhe të shërbimeve, duke mos përfshirë administratën publike, mbrojtjen dhe sigurimin e detyrueshëm social'. Çdo pesë vjet, me këtë anketë, mbledhen të dhëna vetëm nga bizneset me dhjetë të punësuar apo më shumë.¹²

Kosova ka të dhëna disi të krahasueshme, por janë mbledhur duke përdorur metodologji të dhe përkufizimin e të ardhurave të ndryshme. Për shembull, Kosova ka Anketën Strukturore të Statistikave

⁹ Kjo tabelë është përshtatur nga Tabela e IEBGJ 2.8, f. 23.

¹⁰ Instituti Evropian për Barazi Gjinore, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015: Matja e Barazisë Gjinore në Bashkimin Evropian 2005-2012*, 2015, f. 36.

¹¹ Eurostat, Eurostat, Anketa e strukturës së të ardhurave 2014, Eurostat metadata, në http://ec.europa.eu/eurostat/cache/metadata/en/earn_ses2014_esms.htm#unit_measure|4702|12|3472.

¹² 'Fjalor: Anketa e strukturës së të ardhurave,' Eurostat, qasur më 10 dhjetor 2016, në: [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Structure_of_earnings_survey_\(SES\)](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Structure_of_earnings_survey_(SES)).

të Biznesit, që përfshin të dhëna në lidhje me bizneset, por jo punonjësit individualë.¹³ AFP mbledh informata në lidhje me të ardhurat, dhe lloji i aktivitetit të të punësuarve është gjithashtu në dispozicion. Megjithatë, AFP i pyet të anketuarit vetëm në lidhje me pagën e tyre mujore neto. Mënyra në të cilën tatimet dhe përfitimet paguhen në Kosovë mund të kontribuojë në problemet e njohurive në mesin e të anketuarve të cilët mund të mos e dinë pagën bruto, që çon në të dhëna të pasakta. Ndoshta një hap i parë do të ishte që të fillohet duke përfshirë pyetje edhe për të ardhurat neto edhe bruto në AFP, me një përkufizim të qartë të të ardhurave bruto të parashikuara. Kjo mund të kontribuojë gjithashtu për të mësuar me kalimin e kohës, përmirësimin e cilësisë së të dhënave me kalimin e kohës. Në ndërkohë, cilësia e të dhënave mund të kontrollohet në një farë mase, duke përdorur normat e njohura të standardizuara për kontributet pensionale dhe tatimet në nivele të ndryshme të të ardhurave në Kosovë. Për momentin, Kosova mund të përdorë të dhënat e mbledhura përmes AFP si një përfaqësi, edhe pse ato nuk do të jenë plotësisht të krahasueshme me shifrat e përdorura në BE. Në çdo rast, duke pasur parasysh se 30.7% e njerëzve në Kosovë janë të punësuar në administratën publike,¹⁴ dhe në bizneset e vogla,¹⁵ duke përdorur të njëjtën metodologji siç është përdorur në Anketën e Strukturës së të Ardhurave me gjasë nuk do të paraqiste një tablo shumë të saktë të të ardhurave aktuale në Kosovë. Megjithatë, me ndryshimin e përkufizimit të tanishëm të të ardhurave mujore të përdorura në AFP, përfshirja e të ardhurave bruto do të mundësonte krahasimin më të afërt bazuar në përkufizimin e Eurostatit.

Të ardhurat operacionalizohen si të ardhurat mesatare neto të ekuivalentuara për personat mbi moshën 16 sipas Eurostatit, 'Të hyra të disponueshme të ekuivalentuara në SFB (Standardi i Fuqisë Blerëse/PPS - Purchasing Power Standard), janë totali i të hyrave të një familje, pas tatimit dhe ndalesave tjera,, të cilat janë të disponueshme për t'u shpenzuar ose për t'u kursyer, të pjesëtuara me numrin e anëtarëve të familjes, të shndërruara në persona të moshës madhore të ekuivalentuara; anëtarët e familjes ekuivalentohen ose bëhen ekuivalent duke e ponderuar secilin sipas moshës së tyre, duke e përdorur të ashtuquajturën shkallën e modifikuar e ekuivalencës së OBZhE-së'. Periudha referencë e të hyrave është periudha fikse 12-mujore. Eurostat mbledh këto të dhëna me anë të Statistikave të Bashkimit Evropian për të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (EU-SILC), që përfshin një studim në nivel të ekonomive familjare. Kosova ka të dhëna për të ardhurat vjetore të familjes, të mbledhura nëpërmjet rezultateve të Anketës së Buxhetit të Ekonomive Shtëpiake 2015, të cilat mund të përdoren.¹⁶

Nënfisha e dytë e parave, gjendja ekonomike, ka treguesit e varfërisë dhe shpërndarjen e të ardhurave. E para është shkalla e njerëzve 'jo në rrezik-nga-varfëria', që definohet si përqindje e personave 16 vjeç dhe më të vjetër në vend të cilët kanë më shumë se ose e barabartë me të ardhurat mesatare, pas transfereve sociale. Eurostat mbledh këto të dhëna me anë të anketës së njëjtë për të ardhurat dhe kushtet e jetesës. Kosova ka të dhëna për të ardhurat e mbledhura me anë të AFP, të cilat mund të përdoren për të llogaritur të ardhurat mesatare. Pastaj, mund të llogaritet përqindja e personave që fitojnë më tepër se ose barabartë me të ardhurat mesatare, duke dhënë këtë matje.

Treguesi i dytë i 'shpërndarjes së të ardhurave', sipas IEBGj-së është:

Llogaritet si $1 / \text{"raportit S80/S20 të pjesëmarrjes së kuintilit të të ardhurave"} * 100$. Raporti i pjesëmarrjes së kuintilit të të ardhurave përbën matjen e pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave. Ai llogaritet si raporti i të ardhurave totale të pranuar nga 20% e popullsisë me të ardhurat më të larta (kuintili i lartë) me ato të pranuar nga 20% i popullsisë me të ardhurat më të ulëta (kuintili i ulët).

¹³ Për shembull shih: ASK, *Rezultatet e Statistikave Strukturore të Biznesit 2015*.

¹⁴ GAP Instituti, *Reformimi i administratës publike në Kosovë*, korrik 2015, Tabela 2, f. 10, në http://www.institutigap.org/documents/99892_Reforming%20Public%20Administration%20in%20Kosovo.pdf.

¹⁵ Kjo tabelë është përshtatur nga IEBGJ, Indeksi i Barazisë Gjinore 2015, Tabela 3.2, f. 36.

¹⁶ Shih ASK, 'Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare', 2015, f. 18, <https://ask.rks.gov.net/media/1517/results-of-household-budget-survey-2015.pdf>.

Përsëri, duke përdorur të dhëna për të ardhura nga AFP, Kosova mund të llogarisë këtë.

Tabela 2. Paraja¹⁷

Korniza e matjes	Koncepti i matur	Treguesi	Burimi	I disponueshëm në Kosovë	Hapat potencial
Burimet financiare	Pagat	Fitimi mesatar mujor — NACE Rev. 2, kategoritë B-S duke përfshirë O, 10 punonjës apo më shumë (PPS)	Eurostat, Anketa e Strukturës së të pagave	Jo	Futni pagat bruto mujore në AFP
	Të ardhurat	Të ardhurat neto mesatare të ekuivalentuara (PPS, popullsia 16+)	Eurostat, Statistikat e BE-së të ardhurave dhe kushteve të jetesës	Po	Përdorni Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare
Situata ekonomike	Varfëria	Jashtë rrezikut nga varfëria, ≥ 60% të ardhurave mesatare (% , popullsia 16+)	Eurostat, Statistikat e BE-së të ardhurave dhe kushteve të jetesës	Po	Përdorni të dhëna AFP për të llogaritur
	Shpërndarja e të ardhurave	Pjesa S20/S80 e kuintalit të të ardhurave (% , popullsia 16+)	Eurostat, Statistikat e BE-së të ardhurave dhe kushteve të jetesës	Po	Përdorni të dhëna AFP për të llogaritur

Njohuritë

Fusha e njohurive shqyrton dallimet midis grave dhe burrave në lidhje me qasjen dhe pjesëmarrjen e tyre në arsimim dhe trajnim.¹⁸ Kjo fushë ka dy nën-fusha: vijimin e arsimit dhe ndarjen, dhe nxënien gjatë gjithë jetës.

Nën-fusha e parë, vijimi i arsimit dhe ndarja, shqyrton përqindjen e moshës së popullsisë, 15-74, që ka përfunduar fazat e para dhe të dyta të arsimit tretësor, të matur si përqindje e popullsisë totale. Kosova i ka këto të dhëna në dispozicion nga censusi, por edhe nga AFP-ja.

Matja e dytë, ndarja, shqyrton përqindjen e të gjithë studentëve që studiojnë në nivelin e arsimit tretësor në fushat e “Trajnimit të mësimdhënësve dhe edukatës shkencore”, “shkenca humane dhe arte” dhe “shëndetësi dhe mirëqenie”. Mesa duket, Kosova ka të disponueshme vetëm të dhëna në fushën e arsimit dhe arteve, të cilat publikohen çdo vit si pjesë e statistikave arsimore. ASK-ja mund t’u kërkojë të gjitha universiteteve, publike apo private, që të raportojnë numrin e studenteve dhe studentëve që janë regjistruar në secilin prej këtyre programeve, midis programeve të tjera. Këto të dhëna më pas mund të kombinohen dhe të raportohen çdo vit si pjesë e statistikave arsimore.

Nën-fusha e dytë, nxënia gjatë gjithë jetës, sipas IEBGj-së përfshin:

të gjitha aktivitetet e qëllimshme të nxënies, qofshin formale, joformale apo informale, të cilat ndërmerren vazhdimisht me qëllim përmirësimi e njohurive, shkathësive dhe kompetencave. Qëllimi apo synimi i nxënies është pika kritike që i dallon këto aktivitete nga aktivitetet që nuk përfshijnë nxënien, siç janë aktivitetet kulturore apo sportive. Periudha referenciale për pjesëmarrjen në arsim dhe trajnim është katër javë përpara intervistës sikurse ndodh zakonisht në sondazhet për fuqinë punëtore.

¹⁷Kjo tabelë është përshtatur nga IEBGJ, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015*, Tabela 3.2, f. 36.

¹⁸Po aty, f. 42.

Eurostat-i e përdor AFP-në e tij për të matur nxënien gjatë gjithë jetës, e cila operacionalizohet si përqindja e njerëzve të moshës 15-74 vjeçare, të cilët kanë marrë pjesë në arsim dhe trajnime katër javë përpara anketimit. Kosova aktualisht nuk duket se i ka këto informata në dispozicion. Megjithatë, kjo mund të përfshihet në LSF-në e Kosovës, në funksion të standardizimit me AFP-në që përdoret në vende të tjera në Evropë.

Tabela 3. Njohuritë¹⁹

Korniza e matjes	Koncepti i matur	Treguesi	Burimi	I disponueshëm në Kosovë	Hapat potencial
Vijimi i arsimit dhe ndarja	Arsimi tretësor	Të diplomuar të arsimit tretësor (% popullsia 15-75 vjeçare)	Eurostat — EU AFP	Po	Përdorni të dhënat e AFP-së
	Ndarja	Studentët e arsimit tretësor në fushat e “arsimit”, shëndetësisë dhe mirëqenies”, “shkencave humane dhe arteve” (ISCED 5-6) (% studentët e arsimit tretësor)	Eurostat, Unesco/OECD/Eurostat, Pyetësorë për statistikat arsimore	Pjesërisht	Kërkojuni të gjitha universiteteve që të ofrojnë rregullisht të dhëna si pjesë të statistikave arsimore.
Nxënia gjatë gjithë jetës	Nxënia gjatë gjithë jetës	Njerëzit që marrin pjesë në arsimin dhe trajnimin formal dhe joformal (% 15-74 e popullsisë)	Eurostat, EU AFP	Jo	Bëjeni pjesë të AFP-së

Koha

Fusha e “kohës” kërkon të masë kohën që burrat dhe gratë shpenzojnë në aktivitete ekonomike, të kujdesit apo aktivitete sociale. Analizimi i kësaj nga pikëpamja gjinore mund të identifikojë prirjet të cilat mund të kontribuojnë në sigurimin e një baraspeshe më të mirë e më të barabartë midis jetës dhe punës për gratë dhe burrat. Kjo fushë ka dy nën-fusha: aktivitetet e kujdesit dhe aktivitetet sociale.

Nën-fusha e aktiviteteve të kujdesit ka dy matje. Matja e parë shqyrton kujdesin për fëmijë, i cili matet si përqindje e punonjësve të moshës 15 vjeçare apo më të madhe, të cilët kujdesen dhe edukojnë fëmijët dhe nipërit e mbesat e tyre çdo ditë për një ose më shumë orë. Duke përdorur anketën evropiane të kushteve të punës (Eurofound European Working Conditions Survey) (pyetja EF2c), koncepti i kujdesit për fëmijë operacionalizohet me këtë pyetje:

Në përgjithësi, sa shpesh përfshiheni në kujdesin dhe arsimimin e fëmijës suaj apo nipërve e mbesave jashtë punës?

- 1) Çdo ditë për 1 ose më shumë orë
- 2) Çdo ditë apo një herë në dy ditë për më pak sesa 1 orë
- 3) Një apo dy herë në javë
- 4) Një apo dy herë në muaj
- 5) Një apo dy herë në vit
- 6) Asnjëherë

Kjo ndryshore më pas llogaritet duke u mbështetur në përqindjen e personave të punësuar, të cilët kanë dhënë përgjigjen e parë, në raport me të gjithë respondentët që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. Mesa duket, aktualisht Kosova nuk ka ndonjë pyetje që është ekzaktësisht si kjo, edhe pse me anë të pyetjeve shqyrtohen shkaqet për punën me kohë të pjesshme sipas gjinisë apo të qenët joaktiv, duke përfshirë si

¹⁹ Kjo tabelë është përshtatur nga IEBGj, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015*, Tabela 3.3, f. 42.

shkak edhe punën për përkujdesje.²⁰ Pyetja e sipërpërmendur mund të bëhet pjesë thelbësore e AFP-së ose anketës për kushtet e jetesës.

Treguesi i dytë ka të bëjë me aktivitetet familjare, të cilat përcaktohen si përqindje e punëtorëve të moshës 15 vjeçare ose më të madhe, të cilët gatuajnë dhe bëjnë punët e shtëpisë çdo ditë për një apo më shumë orë. E njëjta anketë e Eurofound-it u përdor për të mbledhur të dhëna në BE, ku pyetja e mëposhtme është përdorur për ta operacionalizuar këtë koncept: (EF2d):

Në përgjithësi, sa shpesh merreni me gatimin dhe bëni punët e shtëpisë jashtë punës?

- 1) Çdo ditë për një apo më shumë orë.
- 2) Çdo ditë apo një herë në dy ditë për më pak sesa 1 orë
- 3) Një apo dy herë në javë
- 4) Një apo dy herë në muaj
- 5) Një apo dy herë në vit
- 6) Asnjëherë

Më pas, kjo ndryshore llogaritet si përqindje e personave të punësuar, të cilët kanë zgjedhur përgjigjen e parë, në raport me të gjithë respondentët që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. Gjithashtu, aktualisht Kosova nuk duket se mbledh informata lidhur me veprimtaritë familjare. Megjithatë, kjo mund të bëhet pjesë thelbësore e AFP-së ose anketës për kushtet e jetesës.

Nën-dimensioni i dytë i kohës përbëhet nga aktivitetet familjare, të cilat kanë dy matje. Së pari, aktivitetet sportive, kulturore dhe argëtuese shqyrtojnë përqindjen e punonjësve të cilët janë 15 vjeç ose më të mëdhenj, dhe që janë të përfshirë në “aktivitetet sportive, kulturore, apo argëtuese jashtë shtëpisë për të paktën një herë në dy ditë”. E njëjta anketë e Eurofound-it përdoret me këtë pyetje (EF2g):

Në përgjithësi, sa shpesh përfshihen në aktivitete sportive, kulturore apo argëtuese jashtë shtëpisë, jashtë kuadrit të punës?

- 1) Çdo ditë për 1 ose më shumë orë
- 2) Çdo ditë apo një herë në dy ditë për më pak sesa 1 orë
- 3) Një apo dy herë në javë
- 4) Një apo dy herë në muaj
- 5) Një apo dy herë në vit
- 6) Asnjëherë

Sërish, kjo ndryshore llogaritet si përqindje e personave të punësuar, të cilët kanë zgjedhur përgjigjen e parë, në raport me të gjithë respondentët që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. Krahas kësaj, Kosova nuk ka ndonjë matje të ngjashme aktualisht, por sërish, kjo do të mund të përfshihet në AFP-në apo anketën për kushtet e jetës.

Matja e dytë e aktiviteteve sociale shqyrton përqindjen e personave 15 vjeçarë dhe më të mëdhenj, të cilët “përfshihen në aktivitete vullnetare apo bamirëse, të paktën një herë në muaj”. E njëjta anketë e Eurofoundation-it përdoret për të mbledhur të dhëna me anë të kësaj pyetjeje (EF2a):

Në përgjithësi, sa shpesh përfshihen në aktivitete vullnetare apo bamirëse jashtë shtëpisë, jashtë kuadrit të punës?

- 1) Çdo ditë për 1 ose më shumë orë
- 2) Çdo ditë apo një herë në dy ditë për më pak sesa 1 orë
- 3) Një apo dy herë në javë

²⁰ RrGGK-ja ka disa studime të cilat shtrojnë pyetje lidhur me kujdesin për fëmijë. Megjithatë, askush nuk i shtron pyetjet në të njëjtën mënyrë, kështu që të dhënat nuk janë plotësisht të krahasueshme (për një përmbledhje, shihni: RrGGK, *Kush kujdeset?*, Prishtinë: 2016, f. 23, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20161103153827186.pdf>).

- 4) Një apo dy herë në muaj
- 5) Një apo dy herë në vit
- 6) Asnjëherë

Ndryshorja llogaritet në të njëjtën mënyrë duke marrë përqindjen e personave të punësuar të cilët kanë cilëndo prej katër përgjigjeve të para dhe duke e pjesëtuar me numrin total të atyre që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. Ndonëse Kosova nuk duket se i ka të disponueshme këto të dhëna aktualisht, mund të fillohet mbledhja e tyre përmes AFP-së apo anketave të kushteve të jetesës me anë të përdorimit të të njëjtës pyetje.

Një opsion tjetër më i kushtueshëm por më i dobishëm për mbledhjen e informatave që kanë të bëjnë me të gjitha konceptet në fushën e kohës, është prezantimi i anketës për përdorimin e kohës në Kosovë. Të njëjtat pyetje mund të bëhen brenda kësaj ankete për të mundësuar krahasimin me të dhënat nga Eurofoundation-i. Instalimi i studimit të rregullt për shpenzimin e kohës do të kishte përfitime të tjera për Kosovën, duke përfshirë mundësimin e një të kuptuari më të mirë për llojet e punës informale të paguar dhe të papaguar, që kryhet nga gratë dhe burrat.

Tabela 4. Koha²¹

Korniza e matjes	Koncepti i matur	Treguesi	Burimi	I disponueshëm në Kosovë	Hapat potencial
Aktivitetet e kujdesit	Aktivitetet e kujdesit për fëmijë	Punëtorët që kujdesen për apo edukojnë fëmijët apo nipërit e mbesat, çdo ditë për një apo më shumë orë (% punonjës 15+)	Eurofound, Anketa Evropiane për Kushtet e Punës	Jo	Mbledhja bëhet përmes AFP-së ose prezantimit të anketës për përdorimin e kohës.
	Aktivitete familjare	Punonjësit që merren me gatimin dhe punët e shtëpisë, çdo ditë për një apo më shumë orë (% punonjës 15+)	Eurofound, Anketa Evropiane për Kushtet e Punës	Pjesërisht	T'u kërkohet të gjithë universiteteve të ofrojnë rregullisht të dhëna.
Aktivitetet sociale	Aktivitetet sportive, kulturore dhe argëtuese.	Punonjësit që merren me aktivitete sportive, kulturore ose aktivitete argëtuese jashtë shtëpisë, të paktën një herë në dy ditë (% punonjës 15+)	Eurofound, Anketa Evropiane për Kushtet e Punës	Jo	Mbledhja bëhet përmes AFP-së, anketës së kushteve të jetesës, ose prezantimit të anketës për përdorimin e kohës.
	Veprimtaritë vullnetare dhe bamirëse	Punonjësit që përfshihen në veprimtari vullnetare apo bamirëse, të paktën një herë në muaj (% punonjës 15+).	Eurofound, Anketa Evropiane për Kushtet e Punës	Jo	Mbledhja bëhet përmes AFP-së, anketës së kushteve të jetesës, ose prezantimit të anketës për përdorimin e kohës.

Pushteti

Fusha e pushtetit ka të bëjë me përfaqësimin e grave dhe burrave në pozitat vendimmarrëse. Sigurimi i barazisë gjinore në pozitat e pushtetit është i rëndësishëm për drejtësinë sociale, duke siguruar përfaqësimin e balancuar të shoqërisë në politikë. Indeksi i Barazisë Gjinore identifikon dy nën-fusha të pushtetit: pushtetin politik dhe atë ekonomik. Të gjithë treguesit në fushën e pushtetit, sikurse

²¹ Kjo tabelë është përshtatur nga IEBGj, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015*, Tabela 3.4, f. 47.

përcaktohen nga IEBGJ, përbëjnë “raportin nga popullsia totale në vend e moshës 18 vjeçare e sipër” dhe ndryshorja përkatëse.

Nën-fusha e parë, pushteti politik, matet fillimisht nga përfaqësimi në ministri, ku përfshihen ministrat e rinj plus ata të vjetër. Në Kosovë, informatat lidhur me deputetët (“të rinjtë” dhe ministrat (“të vjetrit”) janë të disponueshme në ABGJ ose thjesht duke parë faqet e tyre zyrtare.²² Më pas, të dhënat demografike lidhur me popullsinë nga 18 vjeç e sipër mund të përdoren për të llogaritur këtë tregues.

Një matje e dytë e pushtetit politik është përfaqësimi parlamentar. Në Kosovë, këto informata janë të disponueshme edhe nga ABGJ-ja ose në faqen e internetit të Kuvendit të Kosovës.²³ Këto, së bashku me të dhënat demografike, mund të përdoren për llogaritjen e këtij treguesi.

Treguesi i tretë i pushtetit politik është përqindja e grave dhe burrave në kuvendet rajonale. Për vendet të cilat nuk kanë kuvende rajonale, përfaqësimi në politikën e nivelit lokal duhet të përfshihet në këtë Indeks. Në Kosovë, përfaqësuesit nga kuvendet komunale mund të përfshihen. Kosova i ka të disponueshme këto të dhëna, të cilat mund të krahasohen me të dhënat demografike, në funksion të përcaktimit të këtij treguesi.

Nën-fusha e dytë e pushtetit në indeksin e barazisë gjinore, ekonomia, matet fillimisht me anë të përqindjes së anëtarëve të bordeve në kompanitë më të mëdha të shpallura publikisht. Aktualisht në Kosovë duket se informatat lidhur me përqindjen e grave dhe burrave që shërbejnë në këto borde nuk duket se janë të disponueshme për publikun. Ndoshta këto informata mund të mblidhen nga Administrata Tatimore e Kosovës ose nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si pjesë e procesit të regjistrimit të bizneseve. Më pas, këto informata mund të raportohen çdo vit ASK-së. Megjithatë, kjo do të kërkonte që organi që bën mbledhjen e të dhënave të kujdesej që informatat të përditësoheshin rregullisht.

Së dyti, pushteti në fushën e ekonomisë matet nga përqindja e anëtarëve të bankës qendrore në një vend të dhënë. Në Kosovë, këto informata janë të disponueshme në faqen e internetit të Bankës Qendrore të Kosovës.²⁴ Sërish, kjo mund të krahasohet me të dhënat demografike me qëllim që të mbërrihet në këtë tregues.

²² Republika e Kosovës, Zyra e Krye-Ministrit, parë për herë të fundit më 9 dhjetor 2016, marrë nga: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,43>.

²³ Republika e Kosovës, Kuvendi, parë për herë të fundit më 9 dhjetor 2016, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,102>.

²⁴ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bordi Ekzekutiv, parë për herë të fundit më 9 dhjetor 2016, marrë nga: <http://bqk-kos.org/?id=6>.

Tabela 5. Pushteti²⁵

Korniza e matjes	Koncepti i matur	Treguesi	Burimi	I disponueshëm në Kosovë	Hapat potencial
Politik	Përfaqësimi në ministri	Përqindja e ministrave (të vjetër/të rinj) (% popullsia 18+)	DP e drejtësisë, gratë dhe burrat në vendimmarrje	Po	Përdorni të dhënat e ABGJ-së
	Përfaqësimi parlamentar	Përqindja e anëtarëve të parlamentit (në të dyja dhomat) (% popullsia 18+)	DP e drejtësisë, gratë dhe burrat në vendimmarrje	Po	Përdorni të dhënat e ABGJ-së
	Përfaqësimi në kuvendet rajonale	Përqindja e anëtarëve të kuvendeve rajonale (% popullsia 18+)	DP e drejtësisë, gratë dhe burrat në vendimmarrje	Po	Përdorni të dhënat e ABGJ-së
Ekonomik	Anëtarët e Bordit	Përqindja e anëtarëve të bordeve në kompanitë më të mëdha të kuotuar, (bordet mbikëqyrëse ose bordet e drejtorëve) (popullsia 18+)	DP e drejtësisë, gratë dhe burrat në vendimmarrje	Jo	Mblidhni përmes Administratës Tatimore të Kosovës ose Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë
	Anëtarë të bankës qendrore	Përqindja e anëtarëve të bankës qendrore (% popullsia 18+)	DP e drejtësisë, gratë dhe burrat në vendimmarrje	Po	Përdorni të dhënat e Bankës Qendrore

Shëndetësia

Fusha e fundit kryesore shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me gjininë dhe shëndetin. Nga pikëpamja konceptuale, këtu përfshihen edhe dy nën-fusha: gjendja shëndetësore dhe qasja në strukturat e shëndetësisë.

Së pari, gjendja shëndetësore matet me treguesin e vetëperceptimit të shëndetit. Në Kosovë, RrGGK-ja ka kryer hulumtimin e parë mbarë-kombëtar për qasjen e grave dhe burrave në kujdesin shëndetësor në vitin 2016.²⁶ Organizata ka përdorur të njëjtin tregues sikurse Eurostat-i në funksion të mundësimin të krahasimeve:

Si e perceptoni shëndetin tuaj në përgjithësi?

- 1) Shumë i mirë
- 2) I mirë
- 3) Disi i mirë
- 4) I keq
- 5) Shumë i keq

Matja e vetëperceptimit të shëndetit llogaritet duke shtuar përqindjen e personave që e kanë konsideruar shëndetin e tyre si “shumë të mirë” dhe “të mirë”. Edhe pse të dhënat e RrGGK-së mund të përdoren aktualisht për të përcaktuar Indeksin e Barazisë Gjinore, Qeveria e Kosovës duhet të gjejë një mënyrë për ta institucionalizuar mbledhjen e të dhënave lidhur me këtë tregues dhe tregues të tjerë të shëndetit. Duke qenë se shumica e të dhënave që kanë të bëjnë me këtë fushë mbledhen përmes anketës së BE-së për të ardhurat dhe kushtet e jetesës, ndoshta Anketimi i Kosovës për Kushtet e Jetesës do të mund të harmonizohet për ta përfshirë këtë pyetje dhe pyetjet e mëposhtme:

²⁵ Kjo tabelë është përshtatur nga IEBGj, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015*, Tabela 3.5, f. 53.

²⁶ Ky hulumtim nuk është publikuar ende.

Së dyti, gjendja shëndetësore matet me anë të pritshmërisë së jetëgjatësisë nga lindja. Sikurse përmblihet nga IEBGj: 'Pritshmëria e jetëgjatësisë është vlera absolute në lindje për gratë dhe burrat dhe totali llogaritet si mesatarja e shifrave për gratë dhe burrat.' Eurostat-i përdor të dhënat e vdekshmërisë për të llogaritur pritshmërinë e jetëgjatësisë nga lindja. ASK-ja i ka prej kohësh këto të dhëna.²⁷

Së treti, gjendja shëndetësore matet me anë të viteve të jetës së shëndetshme në vlerë absolute që nga lindja. IEBGj e përshkruan këtë llogaritje disi më të elaboruar në këtë mënyrë:

Vitet e jetës së shëndetshme (HLY - healthy life years) për gratë dhe burrat. Totali llogaritet si mesatarja e shifrave të grave dhe burrave. HLY mat numrin e viteve të mbetura që personi i një moshe specifike pritët të jetojë pa probleme shëndetësore serioze apo të moderuara. HLY-ja është një tregues i përbërë, në të cilin kombinohen të dhënat e vdekshmërisë me të dhënat për gjendjen shëndetësore nga mini-moduli i shëndetësisë (EU-SILC): pyetja e vetëperceptuar, e cila synon të masë shkallën e çfarëdo kufizimi, për të paktën gjashtë muajt e fundit, për shkak të ndonjë problemi shëndetësor që mund të ketë prekur respondentët lidhur me aktivitetet që ata bëjnë zakonisht. Pritshmëria shëndetësore llogaritet duke përdorur metodën e Sullivan-it, e cila kombinon informatat lidhur me vdekshmërinë me të dhënat e gjendjes shëndetësore. 1. Ndryshoret që përdoren për komponentin e vdekshmërisë: Norma e vdekjeve sipas moshës specifike {Mx}. Probabiliteti i vdekjes midis dy moshave të sakta {qx}. Probabiliteti i mbijetesës midis moshave të sakta {px}. Numri i të gjallëve për moshën e dhënë {lx}. Vitet që ka jetuar personi midis moshës së saktë {Lx} Pritshmëria e jetëgjatësisë në moshën e saktë të dhënë (ex). 2 Ndryshorja që përdoret për gjendjen shëndetësore, në rastin e aftësive të kufizuara.

Kosova prej kohësh i ka të dhënat lidhur me vdekshmërinë, të cilat mund të përdoren për të llogaritur pjesën më të madhe të ndryshoreve. Përjashtim bën matja e aftësive të kufizuara, e cila bëhet duke përdorur pyetjen e mëposhtme nga EU-SILC:

Për të paktën 6 muajt e kaluar, në çfarë niveli jeni kufizuar për shkak të ndonjë problemi shëndetësor, në aktivitetet që njerëzit bëjnë zakonisht?... A do të thoshit se keni qenë:

- 1) seriozisht i kufizuar
- 2) i kufizuar, por jo seriozisht
- 3) aspak e kufizuar

Më pas, pjesa e popullsisë e cila është "e shëndetshme", përkufizohet si "aspak e kufizuar", dhe ata që nuk janë të shëndetshëm ("seriozisht të kufizuar" dhe "të kufizuar, por jo seriozisht", llogariten sipas gjinisë dhe moshës. Në Kosovë, RrGGK-ja i ka mbledhur këto të dhëna kohëve të fundit dhe këto mund të përdoren në të ardhmen e afërt për krijimin e Indeksit të BE-së për Barazinë Gjinore. Megjithatë, në të ardhmen, mbledhja e këtyre të dhënave duhet të institucionalizohet ndoshta përmes anketës për kushtet e jetesës në Kosovë.

Nën-fusha e dytë, qasja, përfshin si indikator përqindjen respektivisht të personave pa nevoja të paplotësuara dhe pa nevoja të paplotësuara dentare. Në pyetje bëjnë pjesë:

A ka ndodhur ndonjëherë gjatë 12 muajve të fundit kur ju keni pasur nevojë të këshilloheni me ndonjë mjek, por nuk jeni këshilluar?

- 1) Po, ka pasur të paktën një rast
- 2) Jo, nuk ka pasur asnjë rast

A ka ndodhur ndonjëherë gjatë 12 muajve të fundit kur ju personalisht keni pasur nevojë të kryeni një ekzaminim dentar apo trajtim, por nuk e keni kryer?

- 1) Po, ka pasur të paktën një rast

²⁷ ASK, *Statistikat e Shëndetësisë* 2015, Prishtinë: ASK, 2016.

2) Jo, nuk ka pasur asnjë rast

Gjithashtu këto janë mbledhur nga RrGGK-ja në vitin 2016, me të njëjtën gjuhë që përdoret nga Eurostat-i në EU-SILC. Ndoshta edhe mbledhja e institucionalizuar e të dhënave për këto pyetje është e mundshme duke i përfshirë ato në anketën për kushtet e jetesës në Kosovës.

Tabela 6. Shëndetësia²⁸

Korniza e matjes	Koncepti i matur	Treguesi	Burimi	Janë në Kosovë	Hapat potencial
Statusi	Vetë-perceptimi i shëndetit	Shëndeti i vetë-perceptuar, i mirë ose shumë i mirë (% popullsia 16+)	Eurostat, statistikat e BE-së për të ardhurat dhe kushtet e jetesës	Po (nuk është institucionalizuar)	Bëjeni pjesë të kushteve të jetesës
	Pritshmëria e jetëgjatësisë	Pritshmëria e jetëgjatësisë në vlerë absolute nga lindja (vite)	BE, Statistikat për të ardhurat dhe kushtet e jetesës, të kombinuara me statistikat demografike të Eurostat-it.	Po	Vazhdoni raportimin lidhur me statistikat shëndetësore
	Vitet e jetës së shëndetshme	Vitet e jetës së shëndetshme në vlerë absolute nga lindja (vite)	BE, Statistikat për të ardhurat dhe kushtet e jetesës, të kombinuara me statistikat demografike të Eurostat-it.	Po (nuk është institucionalizuar)	Inkorporoni aftësitë e kufizuara në anketën për kushtet e jetesës
Qasja	Nevojat mjekësore të paplotësuara	Popullsia që nuk ka nevoja të paplotësuara për kontrollë mjekësore (% popullsia 16+)	Eurostat, Statistikat e BE-së për të ardhurat dhe kushtet e jetesës	Po (nuk është institucionalizuar)	Inkorporojeni në anketën për kushtet e jetesës
	Nevojat dentare të paplotësuara	Popullsia që nuk ka nevoja të paplotësuara për kontrollë dentare (popullsia 16+)	Eurostat, Statistikat e BE-së për të ardhurat dhe kushtet e jetesës	Po (nuk është institucionalizuar)	Inkorporojeni në anketën për kushtet e jetesës

Rreth Pabarazive Ndërsektoriale

Në këtë pjesë analizohen zbrazëtitrat gjinore të cilat mund të ekzistojnë në mes të grupeve të veçanta.²⁹ Treguesi i parë shikon shkallën e pjesëmarrjes në punësim në mesin e personave të cilët kanë lindur në një shtet të huaj krahasuar me shkallën e punësimit të personave vendi i lindjes (apo adresa e zakonshme e nënës në kohën e lindjes) është jashtë vendbanimit të zakonshëm të saj/tij.³⁰ Duket se për momentin Kosova nuk i mbledh këto të dhëna. Megjithatë, kjo mund të inkorporohet në AFP duke e shtuar një pyetje në lidhje me vendin e lindjes së të anketuarit.

Treguesi i dytë që është përdorur për të matur 'diskriminimin dhe arsyet e tjera sociale në punësim' është shkalla e punësimit në mesin e punëtorëve të moshuar (mosha 55 dhe 64). Ky tregues lidhet me prioritetin e politikave të tregut të punës së BE-së për të rritur pjesëmarrjen e punëtorëve më të vjetër në moshë në tregun e punës. Kosova mbledh të dhëna mbi shkallën e punësimit të punëtorëve më të vjetër në tregun e punës përmes AFP.³¹ Përmes AFP, Kosova poashtu mbledh të dhëna mbi përqindjen e personave të moshës 15 deri 54 që janë të punësuar, si pikë krahasuese.

Së fundi, Indeksi i Barazisë Gjinore përdor shkallën e punësimit në mesin e prindërve vetushqyes dhe individëve beqarë të cilët nuk kanë asnjë të varur si një tregues për të përshkruar pabarazitë

²⁸ Kjo tabelë është përshtatur nga IEBGj, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015*, Tabela 3.5, f. 53.

²⁹ IEBGj, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015*, f. 67.

³⁰ Po aty, f. 68.

³¹ ASK, *Rezultatet e Kosovës 2015 Anketa e Fuqisë Punëtore*, Prishtinë, f. 12.

ndërsektoriale. Ky tregues është i rëndësishëm për të analizuar nga perspektiva gjinore sepse statistikat tregojnë se gratë janë më së shpeshti prindër vetushqyes apo kujdestare. Kjo mund të ndikoj negativisht në pjesëmarrjen e tyre në punë, rrjedhimisht gratë do të ballafaqohen me shkallë më të lartë të varfërisë. Kosova nuk duket se ka të dhëna të disponueshme në lidhje me shkallën e punësimit të prindërve apo kujdestarëve vetushqyes, por kjo mund të mbliidhet përmes AKP.

Tabela 7. Pabarazitë Ndërsektoriale ³²					
Korniza Matëse	Matja e Konceptit	Treguesit	Burimi	Janë në Kosovë	Hapat Potencial
Diskriminimi dhe arsyt tjera sociale	Minoritetet dhe/ose migrantët	Punësimi i personave të lindur në shtetet tjera (% , 15–64 popullsia përkatëse)	Eurostat, BE AFP	Jo	Përfshije në AFP
		Punësimi i shtetasve (% , 15–64 popullsia përkatëse)	Eurostat, BE AFP	Jo	Përfshije në AFP
	Punëtorët e moshuar	Punësimi i personave të moshës 55–64 (% , 55–64 popllsia)	Eurostat, BE AFP	Po	LFS
		Employment of people aged 15–54 (% , 15–54 population)	Eurostat, BE AFP	Po	LFS
	Prindërit/ kujdestarët vetushqyes	Shkalla e punësimit të personave që jetojnë në një shtëpi me një të rritur dhe me një apo më shumë fëmijë (% , 15–64 popullsia përkatëse)	Eurostat, BE AFP	Jo	Përfshije në AFP
		Shkalla e punësimit të personave që jetojnë në një shtëpi me një të rritur dhe asnjë fëmijë (% , 15–64 popullsia përkatëse)	Eurostat, BE AFP	Jo	Përfshije në AFP

Treguesi i dytë ndërsektorial që mat pabarazitë në Indeksin e Barazisë Gjinore është dhuna. Siç e ka theksuar IEBGJ, është e vështirë të matet me saktësi dhuna pasi që personat që e kanë përjetuar dhunën kanë tendencë të mos e raportojnë atë. Disa tregues tentativ që masin dhunën direkte të propozuara për tu përdorur, përfshijnë përjetimin e dhunës nga moshë 15 vjeç, dhe respektivisht dhunën e përjetuar gjatë 12 muajve të fundit. Treguesit për të dyja këto peridha fokusohen në dhunën fizike të shkaktuar nga partneri, dhuna seksuale nga partneri, dhuna seksuale nga jo-partner dhe dhuna psikologjike. Në vitin 2014, Agjencia për të Drejtat Themelore e BE-së ka realizuar për herë të parë Anketën e Dhunës ndaj grave në të gjithë Evropën. Ajo sjell së bashku disa matje të dhunës, të cilat janë të operacionalizuara si vijon³³:

Dhuna Fizike

Sa shpesh dikush ju ka:

- shtyer apo goditur?
- rënë shuplakë?
- hedhur ndonjë objekt të rëndë në ju?
- tërhequr apo ju ka kapur për flokësh?
- rrahur me grusht apo ndonjë objekt të rëndë, apo ju ka shkelmuar?
- djegur?
- ka provuar të ju ngulfasë apo të ju ndal frymën?
- prerë apo therrë, apo ka gjuajtur në ju ?
- goditur kokën tuaj kundrejt diçkaje ?

Dhuna seksuale

³² IEBGj, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015*, Tabela 3.7, f. 67.

³³ Po aty., f. 125.

Sa shpesh dikush ju ka:

- detyruar në marrëdhënie seksuale duke ju shtyrë apo duke ju lënduar në ndonjë mënyrë? (nëse e nevojshme: me marrëdhënie seksuale ne mendojmë marrëdhënie seksuale të detyruar orale, si dhe penetrim i dhunshëm anal dhe vaginal)
- përveç kësaj, ka tentuar të ju detyroj në marrëdhënie seksuale duke ju shtyrë apo duke ju lënduar në ndonjë mënyrë? (nëse e nevojshme: me marrëdhënie seksuale ne mendojmë marrëdhënie seksuale të detyruar orale, si dhe penetrim i dhunshëm anal dhe vaginal)
- përveç kësaj, ju ka detyruar të merrni pjesë në ndonjë formë të aktit seksual kur ju nuk keni dashur apo kur ju e kishit të pamundur të refuzoni?
- apo keni rënë dakord për ndonjë aktit seksual sepse ju ishit të frikësuar nga ajo që mund të ndodh nëse ju refuzoni?

Dhuna psikologjike

Sa shpesh ju mund të thoni se partneri i tanishëm apo i kaluar ka:

- provuar të ju ndaloj juve të takoheni me miqtë tuaj?
- provuar të ju kufizoj kontaktin me familjen tuaj të lindjes apo të afërmit?
- insistuar të dij se ku ju jeni në një mënyrë që tejkalon shqetësimin e përgjithshëm?
- është nervozuar nëse ju keni folur me ndonjë burrë tjetër (apo grua tjetër nëse partneri juaj është grua)?
- dyshuar se ju e keni tradhëtuar?
- ndaluar të merrni vendime në lidhje me financat e familjes dhe ju ka ndaluar që ju të bleni gjëra në mënyrë të pavarur?
- ndaluar të punoni jashtë shtëpisë?
- ndaluar të lëshoni shtëpinë, ju ka marr çelësat e veturës apo ju ka mbyllur juve brenda?
- nënvlerësuar apo ju ka turpëruar në prani të personave tjerë?
- nënvlerësuar apo ju ka turpëruar kur ishit vetëm?
- bërë gjëra për t'ju frikësuar apo trembur me qëllim, për shembull ka bërtitur apo ka përplasur gjëra?
- ju ka bërë të shikoni materiale pornografike kundër vullnetit tuaj?
- kërcënuar se do të marrë fëmijët tuaj prej jush?
- kërcënuar të lëndoj fëmijët tuaj?
- lënduar fëmijët tuaj?
- kërcënuar se do të lëndoj apo vrasë dikë që ju e keni për zemër?
- kërcënuar të ju lëndoj juve fizikisht?

RrGGK ka realizuar dy anketime shtëpiake në lidhje me dhunën në vitin 2008 dhe në 2015 respektivisht. Ato janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me ABGJ-në, ASK-në dhe akterët tjerë kyç. Anketimi i njejtë është planifikuar të bëhet në vitin 2017. Anketa e RrGGK-së përmban pyetje të ngjashme me ato të Indeksit të Barazisë Gjinore të BE-së. I vetmi ndryshim kyç në metodologji është se RrGGK ka anketuar vetëm personat mbi moshën 18 vjeç, andaj matja nuk mund të krahasohet tërësisht me atë të përdorur nga BE. Megjithatë, duke pasur parasysh se përqindjet e personave të martuar nën moshën 18 vjeç janë të ulëta, kjo mesiguri nuk do të ndryshonte dukshëm treguesit. Në afat të shkurtër, këto të dhëna mund të përdoren për të përmbledhur tregues ekuivalent në mënyrë që të krijohet Indeksi i Barazisë Gjinore në Kosovë. Në të ardhmen, Qeveria e Kosovës duhet të ndajë fonde për të realizuar një anketim të ngjashëm me atë të përdorur nga Agjencia për të Drejta Themelore e BE-së, ndoshta duke i shtuar disa pyetje shtesë të përshtatura me kontekstin e Kosovës. Në këtë mënyrë, anketa poashtu mund të përdoret për të njoftuar punën në adresimin e dhunës ndaj grave në Kosovë. Anketuesit duhet të jenë të trajnuar mirë dhe me përvojë në të folur me personat që mund të kenë përjetuar dhunë si dhe të respektojnë etikën gjatë hulumtimit kur për subjekt janë njerëzit. Duke e patur parasysh ndjeshmërinë e kësaj teme, Qeveria e Kosovës do të duhet të kontrakttojë ekspert të tillë, si për shembull nga grupet e organizatave që merren me të drejtat e grave

e që kanë përvojë me hulumtime të tilla.

Tabela 8. Dhuna ³⁴					
Korniza Matëse	Matjet e koncepteve	Treguesit	Burimi	Janë në Kosovë	Hapat Potencial
Dhunë direkte	Dhunë nga mosha 15 vjeç	Dhunë fizike nga partneri që nga mosha 15 vjeç	Agjencia e të Drejtave Themelore e BE-së, Anketa në tërë Evropën mbi Dhunën ndaj Grave	Po (nuk është institucion alizuar)	Kontrata të Ekspertizës për anketim të rregullt 5 vjeçar
		Dhunë seksuale nga partneri nga mosha 15 vjeç	Agjencia e të Drejtave Themelore e BE-së, Anketa në tërë Evropën mbi Dhunën ndaj Grave	Po (nuk është institucion alizuar)	Kontrata të Ekspertizës për anketim të rregullt 5 vjeçar
		Dhunë seksuale nga jo-partner nga mosha 15 vjeç	Agjencia e të Drejtave Themelore e BE-së, Anketa në tërë Evropën mbi Dhunën ndaj Grave	Po (nuk është institucion alizuar)	Kontrata të Ekspertizës për anketim të rregullt 5 vjeçar
		Dhuna psikologjike nga partneri që nga mosha 5 vjeç	Agjencia e të Drejtave Themelore e BE-së, Anketa në tërë Evropën mbi Dhunën ndaj Grave	Po (nuk është institucion alizuar)	Kontrata të Ekspertizës për anketim të rregullt 5 vjeçar
	Dhuna në 12 muajt e kaluar para intervistimit	Dhunë fizike nga partneri gjatë 12 muajve të fundit para anketimit	Agjencia e të Drejtave Themelore e BE-së, Anketa në tërë Evropën mbi Dhunën ndaj Grave	Po (nuk është institucion alizuar)	Kontrata të Ekspertizës për anketim të rregullt 5 vjeçar
		Dhunë seksuale nga partneri gjatë 12 muajve të fundit para anketimit	Agjencia e të Drejtave Themelore e BE-së, Anketa në tërë Evropën mbi Dhunën ndaj Grave	Po (nuk është institucion alizuar)	Kontrata të Ekspertizës për anketim të rregullt 5 vjeçar
		Dhunë seksuale nga jo-partner gjatë 12 muajve të fundit para anketimit	Agjencia e të Drejtave Themelore e BE-së, Anketa në tërë Evropën mbi Dhunën ndaj Grave	Po (nuk është institucion alizuar)	Kontrata të Ekspertizës për anketim të rregullt 5 vjeçar

³⁴ Po aty, Tabela 3.8, f. 73.

Rekomandimet

Ky seksion ofron një pasqyrë në lidhje me hapat kryesor që Qeveria e Kosovës mund të ndërmarë, ndoshta e përkrahur nga akterët kyç, në mënyrë që të institucionalizohet mbledhja e të dhënave të cilat ende kërkohen për të krijuar Indeksën e Barazisë Gjimore në Kosovë. Është e rëndësishme të mbahet në mend se këto të dhëna duhet të mblidhen rregullisht dhe sa më afër periudhës kohore kur ato mblidhen edhe në BE në mënyrë që të mundësohet krahasimi i tyre.

- ASK duhet të shtoj disa tregues në AFP e rregullt, për të institucionalizuar mbledhjen e të dhënave për treguesit kyç, përfshirë këtu:
 - Marrëveshje fleksibile personale / familjare
 - Intensitetin e punës
 - Të hyrat mujore bruto me përcaktime të qarta
 - Arritja arsimore e të anketuarit/ës
 - Personat që marrin pjesë në edukime dhe trajnime formale dhe jo formale
 - Vendlindjen e të anketuarit/ës
 - Kohëzgjatja e punësimit në vite
 - Numri i llojit të anëtarëve të familjes (përfshirë edhe në lidhje me prindërit/kujdestarët vetushqyes)
- ASK duhet të mbledhë të dhëna të rregullta që kanë të bëjnë me aktivitetet shtëpiake, kujdesin e fëmijëve dhe aktivitetet shoqërore përmes AFP, Anketën e Kushteve të Jetesës apo studim të përdorimit të kohës.
- ASK duhet të konsideroj iniciimin e anketimit të rregullt të përdorimit të kohës (ndoshta çdo pesë vite). Pasi që këto lloj studimesh janë të kushtueshme, ndoshta fillimisht do të duhej të zhvillohen dhe të institucionalizohen me përkrahjen e BE-së, duke përdorur fondet nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit. Kjo do t'i mundësonte Zyres së BE-së në Kosovë, gjithashtu të bëjë progres drejt përmbyshjes së Planit të Veprimt të BE-së mbi Barazinë Gjimore në Kosovë duke përkrahur institucionalizimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Në të ardhmen, pasi që trupat qeveritare do të përfitonin nga të dhëna të tilla, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë, ndoshta secila prej tyre do të mund të ndante fonde për të mbuluar disa prej shpenzimeve të kësaj ankete, në mënyrë që asnjëri nga akterët ta ketë barrën e vetme për të mbuluar të gjitha shpenzimet. Anketimi i përdorimit të kohës duhet të realizohet me konsultime me të gjithë ekspertët gjimore me përvojë në analizë gjimore.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë zyrtarisht duhet të kërkojë që universitetet private dhe publike të ofrojnë të dhëna mbi regjistrimin e studentëve në "Shëndetësi dhe Mirëqenie" sipas gjinisë, si dhe "Trajnimet e mësimdhënësve dhe shkenca e edukimit" dhe "humanitetet dhe arte". ASK duhet të raportojë këtë informatë si pjesë e Statistikave të Arsimit.
- Administrata Tatimore e Kosovës apo Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë duhet të bëhen përgjegjës për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në baza vjetore në ASK për pjesën e anëtarëve të bordeve në kompanitë e mëdha në Kosovë që janë burra dhe gra.
- Anketa e Kushteve të Jetesës mund të inkorporoj pyetje që kanë të bëjë me shëndetin.
- ASK dhe ABGj duhet të bashkëpunojnë afër me ekspertët gjinor për të institucionalizuar të dhëna të qëndrueshme mbi dhunën ndaj grave. Pyetjet duhet të jenë në përputhshmëri me Agjencinë për të Drejta Themelore të BE-së Anketa e Dhunës ndaj Grave në tërë BE-në, por poashtu duhet të përmbaj pyetje specifike në kontekstin e Kosovës, drejt njoftimit të politikave dhe ngritjes së vetëdijes. Dizajnimet të pyetësorit duket ti kushtohet vëmendje e kujdeshme si dhe trajnimet të anketuesve. Ndoshta grupet e organizatave që merren me të drejtat e grave mund të kontraktohen nga Qeveria e Kosovës për të ndihmuar në mbledhjen e këtyre të dhënave.

Shtojca I. Përmbledhje e fushave dhe treguesve

Kjo tabelë është marrë drejtpërdrejtë nga EIGE (në: <http://eurogender.eige.europa.eu/sites/default/files/events-files/Gender%20Equality%20Index%20variables.pdf>).

Fusha	Nën-fusha	Ndryshorja	Përshkrimi	Burimi
P U N A	Pjesëmarrja	Punësimi ekuivalent me orar të plotë (% popullsia 15+)	Norma e punësimit ekuivalent me orar të plotë (Full-Time Equivalent - FTE) është një njësi për të matur personat e punësuar në një mënyrë që i bën ata të krahasueshëm edhe pse mund të punojnë numër të ndryshëm të orëve në javë. Kjo njësi fitohet duke krahasuar numrin mesatar të orëve të punës së një punonjësi me numrin mesatar të orëve të punës së një punëtori me orar të plotë. Në këtë mënyrë, një punëtor me orar të plotë numërohet si një FTE, ndërsa një punëtor me gjysmë-orari merr pikë në proporcion me numrin e orëve që ai ose ajo punon. Për shembull, një punëtor me gjysmë-orari i angazhuar për 20 orë në javë ku orari i plotë është 40 orë, llogaritet si 0.5 FTE.	Eurostat, LFS. Llogaritjet e Eurostatit nga EU-LFS sipas kërkesës së EIGE-s.
		Jetëgjatësia (vitet) e punës	Treguesi i jetëgjatësisë së punës (OWL) matë numrin e viteve që një person i moshës 15 vjeç pritet të jetë aktiv në tregun e punës gjatë jetës së tij/saj. Ky tregues llogaritet me modelin e probabilitetit duke i kombinuar të dhënat demografike (Tabelat e jetës të disponueshme nga Eurostat për llogaritjen e funksioneve të mbijetesës) dhe të dhënat e tregut të punës (normat e aktivitetit të Anketës së Fuqisë Punëtore sipas një grupmoshe të vetme).	Eurostat, LFS, tabela: Jetëgjatësia e punës - të dhënat vjetore [lfsi_dwl_a]; të disponueshme në: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=lfsi_dwl_a&lang=en
	Ndarja e të dhënave dhe cilësia e punës	Personat e punësuar në arsim, shëndetësi dhe aktivitetet e punës sociale (% 15-64 të punësuar)	Llogaritjet bazohen në të dhënat të cilat janë të disponueshme publikisht në nivel vendi në bazën e të dhënave të Eurostatit. Janë të përfshira këto aktivitete ekonomike (të bazuara në NACE Rev 2): P. Arsimi + Q. Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe punët sociale dhe llogariten si përqindje nga TOTALI. Totali - të gjitha aktivitetet e NACE-s.	Eurostat, LFS, tabela: Punësimi sipas gjinisë, moshës dhe aktivitetit ekonomik (nga 2008 e tutje, NACE Rev.2) - I000 Ofsa_egan2]; i disponueshëm në: http://appsso.eurostatec.euooa.eu/nui/show.do?dataset=lfsaeaan2&lang=en .

		Mundësia për të marrë një ose dy orë të lira gjatë orarit të punës për t'i kryer punët personale ose familjare (punëtorët 15+)	Pyetja: Q43. A mund të thoni që për të marrë leje për një ose dy orë të lira gjatë orarit të punës për t'i kryer punët tuaja personale ose familjare është ...? 1 Aspak e vështirë; 2 Jo shumë e vështirë; 3 Paksia e vështirë; 4 Shumë e vështirë. Ndryshorja llogaritet si përqindje e personave të cilët janë përgjigjur aspak e vështirë nga totali (të cilët janë përgjigjur 1, 2, 3 or 4).	Anketa evropiane e kushteve të punës (European Working Condition Survey - EWCS) e koordinuar nga Eurofound-i.
		Puna me afate të shkurtra (punëtorët 15+)	Pyetja: Q45 Dhe, a përfshihen në punën tuaj afate të shkurtra: 1 Gjithmonë; 2 Pothuajse gjithmonë; 3 Rreth 3/4 e kohës; 4 Rreth gjysmës së kohës; 5 Rreth ¼ e kohës; 6 Pothuajse asnjëherë; 7 Asnjëherë. Ndryshorja llogaritet si përqindje e personave që përgjigjen 1-5 nga totali (të cilët janë përgjigjur 1-7).	Anketa evropiane e kushteve të punës (EWCS) e koordinuar nga Eurofound-i.
P A R A T Ë	Burimet financiare	Mesatarja e të ardhurave mujore (SFB, anketa e vitit 2010)	Të ardhurat në SFB(Standardi i Fuqisë Blerëse), në sektorë, industri, ndërtimtari dhe shërbime (përveç administratës publike, mbrojtjes, sigurimit shoqëror të detyrueshëm) (NACE_R2: B-S_X_O, totali i grupmohës që punojnë në kompani me 10 ose më shumë punonjës).	Eurostat, Anketa për Strukturën e të Ardhurave (SES), tabela: Mesatarja e të ardhurave mujore sipas gjinisë, moshës dhe aktivitetit ekonomik [earn_ses10_20] e disponueshme në http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=earn_ses10_20&lang=en .
		Të hyrat neto mesatare të ekuivalentuara (PPS. popullsia 16+)	Të hyra të disponueshme të ekuivalentuara në SFB (Standardi i Fuqisë Blerëse / PPS - Purchasing Power Standard), janë totali i të hyrave të një familje, pas tatimit dhe ndalesave tjera, të cilat janë të disponueshme për t'u shpenzuar ose për t'u kursyer, të pjesëtuara me numrin e anëtarëve të familjes të shndërruar në persona të moshës madhore të ekuivalentuara; anëtarët e familjes ekuivalentohen ose bëhen ekuivalent duke e ponderuar secilin sipas moshës së tyre, duke e përdorur të ashtuquajturën shkallë e modifikuar e ekuivalencës së OBZhE-së (modified OECD equivalence scale). Periudha referencë e të hyrave është periudha fikse 12-mujore.	Eurostat. EU-SILC (tabela: Mesatarja dhe mediana e të hyrave sipas moshës dhe gjinisë (burimi: SILC [ilc_di03] të disponueshme në: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_di03&lang=en .

	Burimet ekonomike	Jashtë rrezikut nga varfëria mediana prej ≥60% e të ardhurave (16+ të popullatës)	Llogaritur si 100 - "norma e rrezikut nga varfëria". Norma e rrezikimit nga varfëria është raporti i njerëzve me të ardhura të ekuivalentuara e të disponueshme (pas transfertës sociale) nën pragun e rrezikut nga varfëria, i cili përcaktohet se është 60% i medianës në nivel kombëtar, të të ardhurave të ekuivalentuar të disponueshme pas transfereve sociale.	Eurostat, EU-SILC, tabela: Norma e rrezikut nga varfëria sipas pragut të varfërisë, moshës dhe gjinisë (burimi: SILC) [ilc_li02] të disponueshme në: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_li02&lang=en .
		Raporti S20/S80 i kuintilit të të ardhurave (popullsia 16+)	Llogaritet si 1 / "raportit S80/S20 të pjesëmarrjes së kuintilit të të ardhurave" * 100. Raporti i pjesëmarrjes së kuintilit të të ardhurave përbën matjen e pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave. Ai llogaritet si raporti i të ardhurave totale të pranuar nga 20% e popullsisë me të ardhurat më të larta (kuintili i lartë) me ato të pranuar nga 20% i popullsisë me të ardhurat më të ulëta (kuintili i ulët).	Eurostat, EU-SILC, tabela: Raporti S80/S20 i pjesëmarrjes së kuintilit të të ardhurave sipas gjinisë dhe grup-moshës së përzgjedhur (burimi: SILC) [ilc_dil1] i disponueshëm në: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_dil1&lang=en .
N J O H U R I T Ë	Frekuentimi dhe ndarja	Të diplomuarit e arsimit tretësor (15-74% i popullsisë)	Faza e parë dhe e dytë e arsimit tretësor (niveli 5 dhe 6) si përqindje nga totali 15-74 i popullsisë	Eurostat, LFS, tabela: Popullsia sipas frekuentimit të nivelit të arsimit, gjinisë dhe moshës (%) [edat_lfs_9903], e disponueshme në: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=edat_lfs_9903&lang=en .
		Studentët e arsimit tretësor në fushat e ekonomisë, shëndetësisë dhe mirëqenies, shkencave humane dhe artit (studentët e arsimit tretësor)	Llogaritur si përqindja e personave të cilët studiojnë në nivelin e arsimit tretësor në fushat EF14 - trajnim për mësimdhënës dhe edukatë shkencore + EF2 - Shkencat humane dhe artet + EF7 Shëndetësi dhe mirëqenie, nga totali i studentëve në nivelin e arsimit tretësor.	Eurostat, statistikat për arsimin, tabela: Studentët e arsimit tretësor (ISCED 5-6) sipas fushës së arsimit dhe gjinisë [educ_enr15], marrë nga: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=educ_enr15&lang=en .
	Nxënia gjatë gjithë jetës	Njerëzit që marrin pjesë në arsimin dhe trajnimin formal dhe joformal (15-74 e popullsisë)	Nxënia gjatë gjithë jetës përfshin të gjitha aktivitetet e qëllimshme të nxënies, qofshin formale, joformale apo informale, të cilat ndërmerren vazhdimisht me qëllim përmirësimi e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave. Qëllimi apo synimi i nxënies është pika kritike që i dallon këto aktivitete nga aktivitetet që nuk përfshijnë nxënien, siç janë aktivitetet kulturore apo sportive. Periudha referenciale për pjesëmarrjen në arsim dhe trajnim është katër javë përpara intervistës sikurse ndodh zakonisht në sondazhet për fuqinë punëtore.	Eurostat, LFS, tabela: Norma e pjesëmarrjes në arsim dhe trajnim (katër javët e fundit) sipas llojit, gjinisë dhe moshës [trng_lfs_09], marrë nga: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=trng_lfs_09&lang=en .

A H O K	Kujdesi	Punëtorët që kujdesen për apo edukojnë fëmijët apo nipërit e mbesat, çdo ditë për një apo më shumë orë (punonjës 15+)	Pyetja fillestare: EF2c Në përgjithësi, sa shpesh përfshiheni në kujdesin dhe arsimimin e fëmijës suaj apo nipërve e mbesave jashtë punës? 1 Çdo ditë për një apo më shumë orë; 2 Çdo ditë apo një herë në dy ditë për më pak sesa 1 orë; 3 Një apo dy herë në javë; 4 Një apo dy herë në muaj; 5 Një apo dy herë në vit; 6 Asnjëherë. Ndryshorja llogaritet si përqindje e personave të punësuar të cilët janë përgjigjur "Çdo ditë për një apo më shumë orë" nga totali (që janë përgjigjur nga 1 deri 6).	Anketa evropiane e kushteve të punës (European Working Condition Survey - EWCS) e koordinuar nga Eurofound-i.
		Punonjësit që merren me gatimin dhe punët e shtëpisë, çdo ditë për një apo më shumë orë (punonjësit 15+)	Pyetja fillestare: EF2d Në përgjithësi, sa shpesh merreni me gatimin dhe bëni punët e shtëpisë jashtë punës? 1 Çdo ditë për një apo më shumë orë; 2 Çdo ditë apo një herë në dy ditë për më pak sesa 1 orë; 3 Një apo dy herë në javë; 4 Një apo dy herë në muaj; 5 Një apo dy herë në vit; 6 Asnjëherë. Ndryshorja llogaritet si përqindje e personave të punësuar të cilët janë përgjigjur "Çdo ditë për një apo më shumë orë" nga totali (që janë përgjigjur nga 1 deri 6).	Anketa evropiane e kushteve të punës (European Working Condition Survey - EWCS) e koordinuar nga Eurofound-i.
	Aspekti social	Punonjësit që merren me aktivitete sportive, kulturore ose aktivitete argëtuese jashtë shtëpisë, të paktën një herë në dy ditë (punonjësit 15+)	Pyetja fillestare: EF2g Në përgjithësi, sa shpesh përfshiheni në aktivitete sportive, kulturore apo argëtuese jashtë shtëpisë, jashtë kuadrit të punës? 1 Çdo ditë për një apo më shumë orë; 2 Çdo ditë apo një herë në dy ditë për më pak sesa 1 orë; 3 Një apo dy herë në javë; 4 Një apo dy herë në muaj; 5 Një apo dy herë në vit; 6 Asnjëherë. Ndryshorja llogaritet si përqindje e personave të punësuar të cilët janë përgjigjur "Çdo ditë për një apo më shumë orë" ose "Çdo ditë apo një herë në dy ditë për më pak sesa 1 orë" nga totali (që janë përgjigjur nga 1 deri 6).	Anketa evropiane e kushteve të punës (European Working Condition Survey - EWCS) e koordinuar nga Eurofound-i.
		Punonjësit e përfshirë në aktivitete vullnetare apo bamirësie, të paktën një herë në muaj (punëtorët 15+)	Pyetja fillestare: EF2a Në përgjithësi, sa shpesh përfshiheni në aktivitete vullnetare apo bamirësie jashtë shtëpisë dhe jashtë punës? 1 Çdo ditë për një apo më shumë orë; 2 Çdo ditë apo një herë në dy ditë më pak sesa 1 orë; 3 Një apo dy herë në javë; 4 Një apo dy herë në muaj; 5 Një apo dy herë në vit; 6 Asnjëherë. Ndryshorja llogaritet si përqindje e personave të punësuar të cilët janë përgjigjur alternativave 1 deri në 4 nga totali (që janë përgjigjur nga 1 deri 6).	Anketa evropiane e kushteve të punës e koordinuar nga Eurofound-i.
PUSHTETI	Politik	Ndarja e ministrive (popullsia 18+)	Llogaritet si raporti nga popullsia totale në vend e moshës 18 vjeçare e sipër. Të dhënat janë të disponueshme në bazën e të dhënave të Komisionit Evropian për gratë dhe burrat në vendimarrje. Qeveritë kombëtare (të gjitha ministratë: ministrat e rinj + ministrat e vjetër), tremujori i parë. Statistikat e popullsisë mbështeten në bazën e të dhënave të Eurostat-it.	Komisioni Evropian, marrë nga: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/politics/national-governments/index_en.htm

		Përqindja e anëtarëve të parlamentit (popullsia 18+)	Llogaritet si raporti nga popullsia totale në vend e moshës 18 vjeçare e sipër. Të dhënat janë të disponueshme në bazën e të dhënave të Komisionit Evropian për gratë dhe burrat në vendimmarrje. Parlamentet kombëtare (të dyja dhomat), tremujori i parë. Statistikat e popullsisë mbështeten në bazën e të dhënave të Eurostat-it.	Komisioni Evropian, marrë nga: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/politics/national-parliaments/index_en.htm
		Përqindja e anëtarëve të asambleve rajonale (popullsia 18+)	Llogaritet si raporti nga popullsia totale në vend e moshës 18 vjeçare e sipër. Të dhënat janë të disponueshme në bazën e të dhënave të Komisionit Evropian për gratë dhe burrat në vendimmarrje. Asambljetë rajonale, nëse asambljetë rajonale nuk ekziston në vend, përfshihet politika e nivelit lokal. Statistikat e popullsisë mbështeten në bazën e të dhënave të Eurostat-it.	Komisioni Evropian, marrë nga: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/politics/regional-assemblies/index_en.htm dhe http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/politics/municipal-councils/index_en.htm
	Ekonomik	Pjesa e anëtarëve të bordeve në kompanitë më të mëdha të kuotuar, bordet mbikëqyrëse ose bordet e drejtorëve (popullsia 18+)	Llogaritet si raporti nga popullsia totale në vend e moshës 18 vjeçare e sipër. Të dhënat janë të disponueshme në bazën e të dhënave të Komisionit Evropian për gratë dhe burrat në vendimmarrje. Pjesa e anëtarëve të bordeve në kompanitë më të mëdha të kuotuar. Statistikat e popullsisë mbështeten në bazën e të dhënave të Eurostat-it.	Komisioni Evropian, marrë nga: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/business-finance/supervisory-board-board-directors/index_en.htm
		Përqindja e anëtarëve të Bankës Qendrore (popullsia 18+)	Llogaritet si raporti nga popullsia totale në vend e moshës 18 vjeçare e sipër. Të dhënat janë të disponueshme në bazën e të dhënave të Komisionit Evropian për gratë dhe burrat në vendimmarrje. Pjesa e anëtarëve të organeve kryesore vendimmarrëse në bankat qendrore. <u>Statistikat e popullsisë mbështeten në bazën e të dhënave të Eurostat-it.</u>	Komisioni Evropian, marrë nga: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/business-finance/central-banks/indexen.htm .
SHËNDETËSIA	Gjendja	Shëndeti i vetë-perceptuar, i mirë ose shumë i mirë (popullsia 16+)	Llogaritet si përqindja e personave që e vlerësojnë shëndetin e tyre si "shumë të mirë" + përqindja e personave që e vlerësojnë shëndetin e tyre si "të mirë". Shëndeti i vetëperceptuar: koncepti operacionalizohet nga pyetja lidhur me atë se si e percepton një person shëndetin e tij/saj në përgjithësi, duke përdorur kategoritë e përgjigjeve: shumë të mirë/të mirë/disi të mirë/të dobët/shumë të dobët.	Eurostat, EU-SILC, tabela: Vetë-perceptimi i shëndetit sipas gjinisë, moshës dhe statusit të punës (%) [hlth_silc_01], marrë nga: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=hlth_silc_01&lang=en

	Pritshmëria e jetëgjatësisë në vlerë absolute nga lindja.	Pritshmëria e jetëgjatësisë është vlera absolute në lindje për gratë dhe burrat. Totali llogaritet si mesatarja e shifrave për gratë dhe burrat. Pritshmëria e jetëgjatësisë llogaritet nga Eurostat-i duke u mbështetur në të dhënat për vdekshmërinë.	Eurostat, Të Dhënat për Vdekshmërinë, tabela: Vitet e Jetës së Shëndetshme (nga vitit 2004 e këtej) [hlth_hlye], treguesit F_0_LE - Pritshmëria e jetëgjatësisë në vlerë absolute që nga lindja - femrat, dhe M_0_LE - Pritshmëria e jetëgjatësisë në vlerë absolute nga lindja për meshkujt.
	Vitet e jetës së shëndetshme në vlerë absolute nga lindja.	Vitet e jetës së shëndetshme (HLY - healthy life years) për gratë dhe burrat. Totali llogaritet si mesatarja e shifrave të grave dhe burrave. HLY mat numrin e viteve të mbetura që personi i një moshe specifike pritet të jetojë pa probleme shëndetësore serioze apo të moderuara. HLY-ja është një tregues i përbërë, në të cilin kombinohen të dhënat e vdekshmërisë me të dhënat për gjendjen shëndetësore nga mini-moduli i shëndetësisë (EU-SILC): pyetja e vetëperceptuar, e cila synon të masë shkallën e çfarëdo kufizimi, për të paktën gjashtë muajt e fundit, për shkak të ndonjë problemi shëndetësor që mund të ketë prekur respondentët lidhur me aktivitetet që ata bëjnë zakonisht. Pritshmëria shëndetësore llogaritet duke përdorur metodën e Sullivan-it, e cila kombinon informatat lidhur me vdekshmërinë me të dhënat e gjendjes shëndetësore.	Eurostat, EU-SILC dhe të dhënat e vdekshmërisë, tabela: Vitet e Jetës së Shëndetshme (nga vitit 2004 e këtej) [hlth_hlye], treguesit F_0_DFLE - Vitet e jetës së shëndetshme në vlerë absolute që nga lindja - femrat, dhe M_0_DFLE - Vitet e jetës së shëndetshme në vlerë absolute nga lindja - meshkujt.
Qasja	Popullsia që nuk ka nevoja të paplotësuara për kontrolle mjekësore (popullsia 16+)	Përqindja e personave që "nuk kanë nevoja të paplotësuara për të deklaruar", grup-mosha: totali; grupi i të ardhurave; Totali Kujdesi mjekësor: u referohet shërbimeve të kujdesit shëndetësor individual (kontrollit mjekësor apo trajtimit duke përjashtuar kujdesin dental), që ofrohen nga apo nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të mjekësve apo profesionistëve të së njëjtës natyre, sipas sistemeve kombëtare të kujdesit shëndetësor. Shkaqet kryesore për nevojat e paplotësuara, të vëna re në EU-SILC, janë këto: 1. Nuk mund ta përballoja ekonomikisht (kushton shumë), 2. Lista e pritjes, 3. Nuk kam pasur kohë për shkak të punës, kujdesit për fëmijët apo për të tjerët, 4. Është shumë larg për të udhëtuar / nuk ka mjete transporti, 5. Frika nga doktorët (p.sh. dentistët), spitalet, kontrolli ose trajtimi, 6. Doja të prisja e të shihja nëse problemi do të rregullohej vetë, 7. Nuk njihja asnjë mjek të mirë (ose dentist), 8. Shkaqe të tjera.	Eurostat, EU-SILC, tabela: Nevojat e paplotësuara të vetë-raportuara për ekzaminimin mjekësor, sipas gjinisë, moshës, shkaku i detajuar dhe kuntili i të ardhurave (%) [hlth_silc_08], marrë nga: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=hlth_silc_08&lang=en

		Popullsia që nuk ka nevoja të paplotësuara për kontrollë dentare (popullsia 16+)	Përqindja e personave që "nuk kanë nevoja të paplotësuara për të deklaruar", grup-mosha: totali; grupi i të ardhurave; Totali Kujdesi dentar: u referohet shërbimeve të kujdesit shëndetësor që ofrohen nga, apo nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të, stomatologëve (dentistëve). Përfshihet edhe kujdesi shëndetësor që ofrohet nga ortodontistët. Shkaqet kryesore për nevojat e paplotësuara, të vëna re në EU-SILC, janë këto: 1. Nuk mund ta përballoja ekonomikisht (kushton shumë), 2. Lista e pritjes, 3. Nuk kam pasur kohë për shkak të punës, kujdesit për fëmijët apo për të tjerët, 4. Është shumë larg për të udhëtuar / nuk ka mjete transporti, 5. Frika nga doktorët (p.sh. dentistët), spitalet, kontrolli ose trajtimi, 6. Doja të prisja e të shihja nëse problemi do të rregullohej vetë, 7. Nuk njihja asnjë mjek të mirë (ose dentist), 8. Shkaqe të tjera.	Eurostat, EU-SILC, tabela: Nevojat e paplotësuara të vetë-raportuara për ekzaminimin dentar, sipas gjinisë, moshës, shkaku i detajuar dhe kuntili i të ardhurave (%) [hlth_silc_09], marrë nga: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=hlth_silc_09&lang=en
F U Q I A	Politike	Numri i ministrave/ministreve (popullata 18+)	Kalkuluar si raporti prej popullatës totale të moshës 18 e më shumë të një vendi. Të dhënat janë të qasshme në databazën e burrave dhe grave në vendimmarrje, të Komisionit Europian. Qeveritë shtetërore (të gjithë ministrat/ministret, Tremujori i parë, Statistikat e popullatës bazuar në databazën e Eurostat.	Komisioni Europian, i qasshëm në: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/politics/national-governments/index_en.htm
		Numri i ministrave/ministreve të Parlamentit (popullata 18+)	Kalkuluar si raporti prej popullatës totale të moshës 18 e më shumë të një vendi. Të dhënat janë të qasshme në databazën e burrave dhe grave në vendimmarrje, të Komisionit Europian. Parlamentet Shtetërore, Tremujori i parë, Statistikat e popullatës bazuar në databazën e Eurostat.	Komisioni Europian, i qasshëm në: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/politics/national-parliaments/index_en.htm
		Numri i anëtarëve/anëtareve të Asambleve Regjionale (popullata 18+)	Kalkuluar si raporti prej popullatës totale të moshës 18 e më shumë të një vendi. Të dhënat janë të qasshme në databazën e burrave dhe grave në vendimmarrje, të Komisionit Europian. Asambletë Regjionale, nëse asambletë regjionale nuk ekzistojnë në një vend, atëherë të përfshihet politika në nivel lokal. Statistikat e popullatës bazuar në databazën e Eurostat.	Komisioni Europian, i qasshëm në: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/politics/regional-assemblies/index_en.htm dhe http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/politics/municipal-councils/index_en.htm

		Numri i anëtarëve /anëtareve në borde të kompanive me kuota të mëdha, bordi mbikëqyrës apo bordi i drejtorëve/drejtoreshave (Popullata 18+)	Kalkuluar si raporti prej popullatës totale të moshës 18 e më shumë të një vendi. Të dhënat janë të qasshme në databazën e burrave dhe grave në vendimmarrje, të Komisionit Europian. Numri i anëtarëve /anëtareve në borde të kompanive me kuota të mëdha. Statistikat e popullatës bazuar në databazën e Eurostat.	Komisioni Europian, i qasshëm në: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/business-finance/supervisory-board-board-directors/index_en.htm
	Ekonomike	Numri i anëtarëve /anëtareve të Bankës Qendrore (Popullata 18+)	Kalkuluar si raporti prej popullatës totale të moshës 18 e më shumë të një vendi. Të dhënat janë të qasshme në databazën e burrave dhe grave në vendimmarrje, të Komisionit Europian. Numri i anëtarëve /anëtareve, pjesë e trupave vendimmarrës të Bankave Qendrore. Statistikat e popullatës bazuar në databazën e Eurostat.	Komisioni Europian, i qasshëm në: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/gender-decision-making/database/business-finance/central-banks/index_en.htm .

Punimet e Cituara

- ASK, *Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore*, Prishtinë: 2016.
- _____, *Rezultatet e Anketimit të Buxhetit të Ekonomisë Shtëpiake*, Prishtinë: 2016.
- _____, *Rezultatet e Statistikave të Strukturave të Bizneseve 2015*, Prishtinë: 2016.
- _____, *Statistikat e kurorëzimeve 2015*, Prishtina: 2016.
- _____, *Statistikat e Shëndetësisë 2015*, Prishtinë: 2016.
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, “Bordi Ekzekutiv”, në: <http://bqk-kos.org/?id=6>.
- Eurostat, ‘Struktura e anketës së fitimeve 2014’, Eurostat metadata, në:
http://ec.europa.eu/eurostat/cache/metadata/en/earn_ses2014_esms.htm#unit_measure1470211213472.
- _____, ‘Fjalorth: Anketa e Strukturave të Fitimeve, at: [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Structure_of_earnings_survey_\(SES\)](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Structure_of_earnings_survey_(SES))).
- Instituti GAP, *Reformimi i Administratës Publike*, Prishtinë: 2015.
- Instituti Evropian për Barazi Gjinore, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015*: Matja e Barazisë Gjinore në Bashkimin Evropian 2005-2012, Itali: 2015.
- _____, ‘Serbia – kandidati i parë i BE-së që ka prodhuar Indeksin e Barazisë Gjinore, 2 shkurt 2016, at: <http://eige.europa.eu/news-and-events/news/serbia-first-eu-candidate-country-produce-gender-equality-index?lang=en>.
- Këshilli i Bashkimit Evropian, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, *Përfundimet e Këshillit mbi Planin e Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020*, Këshilli i Bashkimit Evropian, 2015.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>.
- Republika e Kosovës, Kuvendi, në: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,102>.
- _____, Zyra e Kryeministrit, në: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,43>.
- RrGGK, *Kush Kujdeset?*, Prishtinë: 2016.
- _____, *Si mund të ndikoj Anëtarësimi në BE në Barazinë Gjinore në Kosovë?*, Dokument për diskutim, Prishtinë: 2016.